



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**KUVENDI I KOSOVËS**

**PROCESVERBAL**  
**NGA PUNIMET E Mbledhjes së VIII-të të Seancës Plenare**  
**MBAJTUR ME 13.06.2002 .**

Mbledhja e Kuvendit të Kosovës filloi në ora 10:00 dhe në te mernin pjesë 75 Deputet.

Seancën Plenare e kryesoi dhe udhëheqi **Prof.Dr Fatmir Sejdiu** me Kryesin e punës nga këta anëtar të Kryesisë :

**z. Xhavit Haliti** anëtar,  
**z. Hydajet Hyseni** anëtar,  
**z. Gojko Saviç** anëtar  
**z.. Oliver Ivanović** anëtar  
**zon.Claressa Surtees** shefe e Sh.Juridik.

**z. Prof dr. Fatmir Sejdiu** hapi mbledhjen dhe i njoftoi deputetët se këtë mbledhje do ta udhëheqi,pasi Kryetari i Kuvendit të Kosovës z.Nexhat Daci ndodhet në një vizitë zyrtare në SHBA,me një grup deputetësh prej 29 vetash,propozoi

**R e n d i n e d i t ë s**

1. Debat mbi Rregulloren për krijimin e Agjensionit të Mirbesimit të Kosovës (AMK).
2. Emërimi i anëtarëve të ri të komisioneve
3. Të ndryshme.

Kryesusi i mbledhjes pyet deputetët se a pajtoheni me rendin e ditës,i cili është aprovuar pa vërrejtje nga ana e deputetëve.

Kryesuesi filloi me pikën e parë të rendit të ditës ,dhe pyet deputetët se Draftregulloren se a e keni marrë,dhe sigurisht ,Komisioni për buxhet,Qeveria i kanë çëndrimet e veta, prandaj ftoi Kryeministrin e Qeverisë që ta marri fjalën.

#### **z. Bajram Rexhepi Kryeministri i Qeverisë së Kosovës theksoi:**

Kjo Rregullore është propozuar para më tepër se një muaj nga Përfaqësuesi Special i KB në Kosovë, dhe iu është lënë në disponim Qeverisë që ta analizoi. Nga kjo z. Rexhepi ka parashtruar 10 vrejtje ,4 prej të cilave Administrata e UNMIK-UT I ka aprovuar kurse të tjerat kanë mbetur objekt diskutimi

- Propozimi I Qeverisë ishte që tre drejtorët që marin pjesë në bordin e Drejtorëve të jenë Ministra , për arsye se aty nuk ka qenë e precizuar, se përfaqësuesi serbë ai duhet të jetë i këtij niveli dhe kjo është pranuar .
- Kërkesa e miratuar ishte kyqja e Kryetarit BSDAK, si anëtar i bordit me qka është shtuar numri .
- Kërkesa ishte që njeri nga drejtorët e këtij bordi të jetë nënkrytarë,dhe nga radha e shqiptarëve e cila është pranuar .
- Është kërkuar që dy Kosovarë të jenë partnerë të barabartë gjatë procesit të operacionalizimit të procesit të privatizimit dhe të hartojnë Rregullorën për politikën operationale. Qeveria i ka propozuar z.Fatmir Sejdiun dhe Ahmet Shalën.

Kërkesat të cilat i ka bërë Qeveria e Kosovës janë pranuar dhe disa priten të planifikohen me politikat operationale .

Ai në fund preku edhe çështjen rreth grumbullimit të mjeteve të cilat gjatë procesit të privatizimit të mbeten në Bankat Kosovare ,dhe me to të investohen në ato fonde ku kanë perspektiv.

**z. Ali Sadriu Ministër i Financave .** Ai themelimin e kësaj Agjensie e vlersoi si ngjarje të rëndësishme për Kosovën, meqenëse dinamika në procesin e privatizimit do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve për vendet e reja të punës që do të ulë shkallën e papunësis në Kosovë.Të njejtin mendim e kishte edhe Deputeti **Fatmir Rexhepi.**

#### **z. Bujar Dugolli Shef I Grupit Parlamentar të AAK-së.**

Ai parashtrroi disa vrejtje në Draftin e propozuar ,duke përfshir zgjerimin e Bordit mbikëqyrës në të cilën do të përfshihen përfaqësuesit nga **Parlamenti, Oda Ekonomike dhe Sindikata** .Sipas tij është e papranueshme mos definimi i kësaj Agjensie.

**z. Ramadan Kelmendi**, shtoi se në këtë Draftregullore nuk është definuar se me privatizimin e Ndërmarrjeve çfarë do të bëhet me tokën ku ato janë ndërtuar, dhe me punëtorët të cilët kanë punuar në to. Pastaj edhe Deputeti **Sillobodan Bijeliç** theksoi se kishin siguruar kopjet e vrejtimeve të Qeverisë. Pastaj debatuan Deputetët **Bislim Hoti**, **Gjevdet Neziri**, **Sahit Krasniqi**,

Ndërsa **z. Gani Prekopuca** theksoi : Se procesi i privatizimit nuk do të jetë i sukseshem nëse nuk përcaktohet dinamika e këtij procesi.

**z. Muhamet Kelmendi** Ai pati vërtetje në Draftregulloren , e cila është shpërndar me vonës, dhe se deputetët nuk kanë pasur kohë për të pregaditur vërejtjet. Miëpo për këtë fajson Sekretarin e Kuvendit, I cili nuk ishte present në mbledhje, dhe propozon që kjo Rregullore tu shpërdahet komisioneve të Kuvendit në shqyrtim.

**z. Xhavit Haliti** anëtar i Kryesisë së Kuvendit, ai propozoi që Kuvendi i Kosovës të pushoi me debate të cilat nuk janë në kompetencë të këtij institucioni ,dhe të merret me qeshtje e caktuara më kornizë Kushtetuese . Ne miratuar një Rezolutë e ajo zgjati pesë minuta. Ne për të cilën po debatohet është e rezervuar për **z. Shtajner**. Ai këtë e lenë në Parlament vetëm sa mos t'ij fyjë rëndë deputetët, sepse në fund të fundit **z. Shtajner** vëtë do ta nenshkruaj.

Rrethë pikes se dytë Kuvendi ka aprovuar plotësimin e numrit të Komisioneve të Kuvendit të Kosovës.

**Në të ndryshme ;** Fjala iu dha shefit të grupit Parlamentar

**z. Fatmir Limaj**; Ai në fillim dha vërejtje ,në matriale të pa pregaditura ,në mos pregaditjeve të mbledhjeve për Kuvend ,në Rregulloren e punë se Kuvendit. kërkoj sqarime për betimin e Qeverisë para **z. Shtajner** ,dhe kishte propozim që betimi të bëhet para Kuvendit .Edhe deputetët **Hajredin Kuqi**,**Bujar Dugolli** kishin të njëjtin mendim dhe si vërtetje iu drejtua Kryesisë së Kuvendit pse kishte refuzuar propozimin që betimi të bëhet në Kuvend.

**z. Muhamet Kelmendi** ka pohuar se me betimin e vëtë para PS-KB-së Qeveria e Kosovës ka bërë shkelje procedurale duke neglizhuar institucionin nga i cili është zgjedhur .

**“Kuvendi është organi që ka zgjedhur këtë Qeveri, prandaj ,ato kanë obligim që të betohen para tij”** Ai përsëriti propozimin e mëparshëm ,për formimin e dy Komisioneve njëni do të ishte për hulumtimin e fatit të zhdukurve dhe zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit, ndërsa tjetri Mergaten.,pastaj debatuen deputetët **Ali Ahmeti**,

**Driton Lajqi, Blerim Baruti, Hajredin Kuqi, Remzije Limanaj, Sadik Rrustemi, Idriz Sadiku etj.**

Si rezyme z. Sejdiu tha se vërejtjet e dhëna do tju lehen në dispozicion komisioneve përkatëse, dhe nëse ka nevoj do të thuret edhe një seanc për të diskutuar këtë çështje, vërejtjet kanë qenë productive.

**Në kohën kur debatonin deputetët në Kuvendë disa nëna Gjakovare të personsave të zhdukur protestonin para dyerve të Kuvendit, duke kërkuar zbardhjen e fatit të zhdukurëve të luftës.**

Kuvendi lidhur me këtë propozoi një grup punues prej 4 antarëve të përbër nga deputetët **Hydajet Hyseni, Nimon Ali Musaj, Ali Ahmeti dhe Nafije Gash**, që ta përpilonin një deklarim në të cilën i bënë thirrje Bashkësis Ndërkombëtare për një trysni më të madhe në Beograd për të dhënë informacione rreth të zhdukurve të luftës, dhe ka mar përsipër në ngritjen e një komisioni për të zhdukurit.

**Anëtarët e Kryesis Gojko Saviç dhe Oliver Ivanoviç** lëshuan sallën e mbledhjes dhe nuk votuan për deklarim.

U dha pauza Deputetëve gjer sa ta përpilojn grupi punues deklarim.

Pas pauzës deklarim e lexoi para deputetëve të pranishëm **z. Hydajet Hyseni dhe e njejta u aprovua nga deputetët e Kuvendit, si dhe u caktua grupi punues, që do të bisedonin me nënat Gjakovare .**

Seancën Plenare e shpalli të përfunduar z. Fatmir Sejdiu në ora 13:00.

Me 13.06.2002

Shërbimi Juridik